



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2018-01

**Vendosi:** Paneli i përbërë prej Gjykatëses së Vetme  
Gjykatëse Marzhori Masëlo

**Administratorja:** Fidelma Donlon

**Data:** 27 janar 2025

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

### Urdhër për Transferimin e Dokumenteve

---

**Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Nina Tavakoli  
Sofi Menegon

**Zyrës Administrative**  
Njesisë së Administrimit të Gjykatës

**Mbrojtësit Kujdestar të Bashkim  
Smakajt**  
Bas Martens

**Mbrojtësit Kujdestar të Isni Kilajt**  
Ian Eduards  
Xho Holms

**Mbrojtësit Kujdestar të Fadil Fazliut**  
Mihil Pestman

**Mbrojtësit Kujdestar të Hajredin  
Kuçit**  
Aleksandër Admiral

**GJYKATËSJA E VETME**,<sup>1</sup> në bazë të nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, lëshon këtë urdhër.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Midis 15 dhjetorit 2023 dhe 12 nëntorit 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") i dorëzoi për konfirmim Gjykatësës së Procedurës Paraprake të Çështjes KSC-BC-2023-12 ("Çështja 12"),<sup>2</sup> aktakuzat kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit (bashkërisht, "të dyshuarit" ose "të akuzuarit").<sup>3</sup>

2. Më 20 nëntor 2024, Gjykatësja e Vetme e urdhëroi ZPS-në të bënte parashtrime mbi transferimin e dokumenteve nga dosja KSC-BC-2018-01 ("dosja hetimore") në dosjen e Çështjes 12, me qëllim që të dyshuarit (e atëhershëm) të kishin qasje në parashtrimet e protokolluara dhe vendimet relevante të dosjes hetimore, në rast se konfirmoheshin akuzat kundër tyre.<sup>4</sup>

3. Më 27 nëntor 2024, ZPS-ja i dorëzoi parashtrimet e veta ku identifikonte disa qindra parashtrime të protokolluara që duheshin transferuar ("Parashtrimet e ZPS-së").<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2018-01, F00697, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësës së Vetme*, 6 qershor 2024, publik. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 12 korrik 2024, F00697/COR.

<sup>2</sup> KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

<sup>3</sup> KSC-BC-2023-12, F00059, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Setting the Date for Initial Appearances and Related Matters](#) (Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje lidhur me Të) ("Vendimi për Paraqitjet e Para"), 6 dhjetor 2024, publik, para. 1.

<sup>4</sup> KSC-BC-2018-01, F00793, Gjykatësja e Vetme, *Urdhër për Parashtrime në lidhje me Transferimin e Dokumenteve*, 20 nëntor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>5</sup> KSC-BC-2018-01, F00799, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në Bazë të Urdhrit F00793*, 27 nëntor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

4. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi një pjesë të akuzave kundër pesë të dyshuarve.<sup>6</sup> Më 5 dhjetor 2024, (tani) të akuzuarit u arrestuan ose atyre iu dorëzua fletëthirrja për t'u paraqitur në gjykatë<sup>7</sup> dhe, më 8 dhe 9 nëntor 2024, ata u paraqitën para Gjykatësës së Procedurës Paraprake.<sup>8</sup>

## II. DISKUTIM

5. Pas konfirmimit të akuzave kundër të akuzuarve dhe arrestimit/fletëthirrjes së tyre, Gjykatësja e Vetme e konstaton të domosdoshme që atyre t'u mundësohet qasja në çdo parashtrim të protokolluar dhe vendim të lëshuar të dosjes hetimore që ka të bëjë me ta apo që është relevant për Çështjen 12.

### A. TRANSFERIMI I PARASHTRIMEVE TË PROTOKOLLUARA NË NJË NËNDOSJE

6. Gjykatësja e Vetme ka parasysh listën e parashtrimeve të protokolluara të përpiluar nga ZPS-ja dhe e urdhëron Zyrën Administrative: (i) të hapë një nëndosje brenda dosjes së Çështjes 12, dhe ta emërtojë me shkurtesën "INV",<sup>9</sup> si pjesë integrale e dosjes së Çështjes 12 ("nëndosja INV e Çështjes 12"); dhe (ii) sa më shpejt që të jetë e realizueshme, të kopjojë dhe protokollojë në mënyrë të dyfishtë në nëndosjen INV të Çështjes 12 dokumentet e mëposhtme (përfshirë shtojcat, përkthimet dhe versionet e redaktuara dhe/ose të korrigjuara) si më poshtë:

---

<sup>6</sup> [Decision on Initial Appearances](#) (Vendimi për Paraqitjet e Para), para. 2.

<sup>7</sup> KSC-BC-2023-12, F00042, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Bashkim Smakajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, publik; F00043, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Isni Kilajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, publik; F00045, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Fadil Fazliut sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, publik; F00046, Administratorja, *Njoftim i Dorëzimit të Fletëthirrjes për Paraqitje në Gjykatë për Hajredin Kuçin*, 5 dhjetor 2024, publik; F00048, Administratorja, *Njoftim i Dorëzimit të Fletarrestimit për Hashim Thaçin sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, publik.

<sup>8</sup> [Decision on Initial Appearances \(Vendimi për Paraqitjet e Para\)](#), para. 22; KSC-BC-2023-12, F00063, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Rescheduling Initial Appearance of Isni Kilaj](#) (Vendim mbi Ricaktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Isni Kilajt), 7 dhjetor 2024, publik.

<sup>9</sup> KSC-BD-15, Administratorja, [Registry Practice Direction on Files and Filings before the Kosovo Specialist Chambers](#) (Udhëzues Pune i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës), 17 maj 2019, publik, neni 21(3).

- (i) Urdhër për Parashtrime në lidhje me Transferimin e Dokumenteve (F00793, 20 nëntor 2024), Parashtrimet e ZPS-së (F00799, 27 nëntor 2024) dhe urdhri aktual të kopjohen dhe protokollohen në mënyrë të dyfishtë, sipas kësaj renditjeje;
- (ii) të gjitha parashtrimet e tjera të protokolluara të renditura në Shtojcën 1 të Parashtrimeve të ZPS-së (F00799/A01, 27 nëntor 2024), të vijojnë më pas, me ndryshimet e mëposhtme:
  - (a) të mos kopjohen apo protokollohen në mënyrë të dyfishtë parashtrimet e protokolluara F00463, F00485, F00505, F00508, F00511, F00512, F00522, F00528, F00546, F00558, F00562, F00564, F00567, F00572, F00580, F00583, F00587, F00590, F00591, F00594, F00605, F00618, F00622, F00624, F00625, F00626, F00631, F00634, F00688, F00715, RAC002/F00003, RAC002/F00004, RAC002/F00005 dhe RAC002/F00006 pasi nuk kanë të bëjnë me asnjërin prej të akuzuarve në Çështjen 12;
  - (b) të mos kopjohen apo protokollohen në mënyrë të dyfishtë as parashtrimet e protokolluara F00615, F00630, F00687 dhe F00698, pasi kanë të bëjnë me kërkesa për zëvendësimin ose vetëtërhejjen e Gjykatësit të Vetëm (të atëhershëm) dhe, si të tilla, nuk kanë të bëjnë me Çështjen 12;
  - (c) të mos kopjohet apo protokollohet në mënyrë të dyfishtë as parashtrimi i protokolluar F00671, pasi ka të bëjë me riklasifikimin e parashtrimit të protokolluar F00669, i cili nuk është përfshirë në Shtojcën 1 të Parashtrimeve të ZPS-së; dhe
  - (d) të shtohen dhe protokollohen në mënyrë të dyfishtë parashtrimet e protokolluara F00644, F00779 dhe F00782, pasi kanë të bëjnë me personat e akuzuar në Çështjen 12.

Parashtrimet e protokolluara të renditura në Shtojcën 1 të Parashtrimeve të ZPS-së me ndryshimet e mësipërme, bashkë me parashtrimet e protokolluara F00644, F00779 dhe F00782, të protokollohen në mënyrë të dyfishtë në Çështjen 12 duke ndjekur numrin rendor të protokollit të dosjes hetimore; dhe

(iii) të vijojnë më pas parashtrimet e protokolluara F00797, F00798, F00800 deri F00807, F00808, F00809, F00812 dhe F00813, sipas kësaj renditjeje.

7. Parashtrimet e protokolluara që i janë dorëzuar Gjykatësës së Vetme gjatë hetimit, apo që janë lëshuar prej saj, dhe të cilat do të kopjohen në nën-dosjen INV të Çështjes në përputhje me këtë urdhër (shih paragrafin 6), do të njihen në vijim si “Parashtrimet e Protokolluara të Kopjuara”.

#### B. KLASIFIKIMI I PARASHTRIMEVE TË PROTOKOLLUARA TË NËNDOSJES

8. Parashtrimet e Protokolluara të Kopjuara që do të protokollohen në mënyrë të dyfishtë në nëndosjen INV të Çështjes 12 do të mbajnë klasifikimin që kanë në dosjen hetimore, në rast se nuk urdhërohet ndryshe. Gjykatësja e Vetme vëren se ZPS-ja ka lënë të kuptohet në Parashtrimet e ZPS-së se synon t'i rishikojë parashtrimet e protokolluara që do të protokollohen në mënyrë të dyfishtë të cilat ende nuk u janë vënë në dispozicion të akuzuarve në Çështjen 12, me qëllim që ata të kenë qasje në këto parashtrime të protokolluara.<sup>10</sup>

#### C. QASJA NË PARASHTRIMET E PROTOKOLLUARA NË NËNDOSJE

9. Si rregull i përgjithshëm, Parashtrimet e Protokolluara të Kopjuara do të jenë të qasshme për pjesëmarrësit në Çështjen 12 që kanë qasje edhe në dosjen hetimore.

10. Në rast se ndonjëri prej Parashtrimeve të Protokolluara të Kopjuara (përfshirë ato që nuk kanë shënimin *ex parte*) është i qasshëm në dosjen hetimore për ZPS-në

---

<sup>10</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

dhe/ose ndonjërin prej të akuzuarve në Çështjen 12, Gjykatësja e Vetme e urdhëron Zyrën Administrative t'i regjistrojë dhe t'i shënojë parashtrimet e protokolluara në fjalë në nën-dosjen INV të Çështjes 12 si *ex parte* për pjesëmarrësit e tjerë në Çështjen 12. Në rast paqartësie, Gjykatësja e Vetme e fton Zyrën Administrative të konsultohet me Trupin Gjykses përkatës.

D. RIKLASIFIKIMI OSE VERSIONET E TJERA TË PARASHTRIMEVE TË PROTOKOLLUARA TË KOPJUARA

11. Duke mbajtur parasysh parimin e gjykimit publik, udhëzohen ZPS-ja, Zyra Administrative dhe Mbrojtja ("palët parashtruese"), sipas rastit, të përgatisin, kur të jetë e mundur, versione të redaktuara (konfidenciale ose publike) të Parashtrimeve të Protokolluara të Kopjuara, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në vijimësi, jo më vonë se **të hënën, 3 mars 2025**.<sup>11</sup> Çdo version i ardhshëm i redaktuar (konfidencial ose publik) ose i korrigjuar i Parashtrimeve të Protokolluara të Kopjuara dorëzohet nga pala parashtruese e dosjes hetimore. Gjithashtu, pala parashtruese njofton Zyrën Administrative, në kohën e dorëzimit të parashtrimit, me qëllim që çdo version i ardhshëm i redaktuar (konfidencial ose publik) ose i korrigjuar i parashtrimeve të protokolluara në fjalë të protokollohet në mënyrë të dyfishtë edhe në nëndosjen INV të Çështjes 12. Zyra Administrative do t'i kopjojë versionet e redaktuara (konfidenciale ose publike) ose të korrigjuara në nëndosjen INV të Çështjes 12.

12. Kërkesat për riklasifikim lidhur me çdonjërin prej Parashtrimeve të Protokolluara të Kopjuara dorëzohen në dosjen hetimore brenda të njëjtit afat. Gjykatësja e Vetme do të marrë vendim mbi riklasifikimin e parashtrimit të protokolluar (origjinal) në dosjen hetimore dhe do të urdhërojë riklasifikimin e njëjtë të parashtrimit të protokolluar përkatës në nëndosjen INV të Çështjes 12, me qëllim që të dy parashtrimet e protokolluara të ruajnë të njëjtin klasifikim në të dy regjistrat.

---

<sup>11</sup> *Shih* Parashtrimet e ZPS-së, para. 3(i).

13. Në rast se pala parashtruese gjykon se ndonjëri prej parashtrimeve të protokolluara dhe/ose shtojcave që lidhen me njërin a më shumë prej të akuzuarve nuk duhet t'i vihet në dispozicion të akuzuarve të tjerë në Çështjen 12, ajo palë duhet ta arsyetojë qëndrimin e vet.

E. PARASHTRIMET E PROTOKOLLUARA TË REJA

14. Duke pasur parasysh se hetimet vazhdojnë, Gjykatësja e Vetme udhëzon ZPS-në, Zyrën Administrative dhe/ose Mbrojtësit ta dorëzojnë çdo parashtrim të protokolluar si më poshtë:

- (i) çdo kërkesë, raport apo parashtrim i protokolluar që ka të bëjë vetëm me hetimin e akuzave në Çështjen 12 dhe që përfshin vetëm të akuzuarit dorëzohet në dosjen e zakonshme të Çështjes 12 (dhe jo në nën-dosjen INV të Çështjes 12); dhe
- (ii) çdo kërkesë, raport apo parashtrim i protokolluar që përfshin të akuzuarit dhe akuzat në Çështjen 12, po nuk kufizohet me to, dorëzohet në dosjen hetimore. Gjykatësja e Vetme ka kompetencë për ta udhëzuar Zyrën Administrative që t'i kopjojë e protokollojë në mënyrë të dyfishtë parashtrimet e protokolluara të kësaj kategorie në një fazë të mëvonshme në dosjen e rregullt të Çështjes 12 apo në ndonjë regjistër tjetër.

F. META-TË DHËNAT NË SISTEMIN *LEGAL WORKFLOW*

15. Për ta bërë sa më të thjeshtë kërkimin e Parashtrimeve të Protokolluara të Kopjuara në *Legal Workflow*, Gjykatësja e Vetme gjithashtu e udhëzon Zyrën Administrative që në meta-të dhënat e secilit Parashtrim të Protokolluar të Kopjuar të përfshijë numrin e protokollit të tij në dosjen hetimore. Zyra Administrative do të vendosë vetë si ta zbatojë konkretisht këtë udhëzim.

16. Pas përfundimit të kopjimit dhe transferimit, Zyra Administrative parashtron në nëndosjen INV të Çështjes 12 një tabelë të letërkëmbimit, ku rendis numrin e ri të dokumentit për secilin Parashtrim të Protokolluar të Kopjuar si dhe numrin përkatës të dokumentit në dosjen hetimore.

#### G. URDHRI PËR RIKLASIFIKIM

17. Në fund, Gjykatësja e Vetme e urdhëron Zyrën Administrative ta riklasifikojë si publik Urdhrin për Parashtrime në lidhje me Transferimin e Dokumenteve (F00793) para kopjimit dhe protokollimit të tij të dyfishtë në nëndosjen INV të Çështjes 12.

### III. VENDIM

18. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Vetme:

- a) **URDHËRON** Zyrën Administrative, ZPS-në dhe Mbrojtjen, sipas rastit, të zbatojnë udhëzimet e paraqitura më lart të Gjykatësës së Vetme; dhe
- b) **URDHËRON** Zyrën Administrative ta riklasifikojë si publik urdhrin F00793 para kopjimit dhe protokollimit të tij të dyfishtë në nën-dosjen INV të Çështjes 12.

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/

**Gjykatëse Marzhor Masëlo**

**Gjykatëse e Vetme**

E hënë, 27 janar 2025

Në Hagë, Holandë.